



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTRE SHTETI PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES



Raporti XVI
mbi trajtimin e ankesave dhe
sugjerimeve të sipërmarrjes
për muajin dhjetor 2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA
MINISTRE SHTETI PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës,

Si Ministre e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, në përmbushje të misionit të ndërmarrë për përmirësimin e klimës së biznesit në vend, lejomëni të ndaj me ju raportin e gjashtëmbëdhjetë të trajtimit të ankesave në kuadër të njoftimeve periodike dhe raportimit mbi punën e kryer gjatë secilit muaj të kaluar.

Kam kënaqësinë t'ju informoj se premtimet e dhëna nga Qeveria për lehtësimin e barrës fiskale të biznesit në vend tashmë janë bërë realitet:

- Nga data 1 janar janë ulur ndjeshëm taksat për qytetarët dhe bizneset. 16 mijë qytetarë do paguajnë 300 mijë lekë taksa më pak në vit.
- 11 mijë biznese me xhiro deri në 14 milionë lekë do paguajnë gjithashtu 3 herë më pak tatim fitimi nga 1 janari, i cili nga 15% shkon në 5%.
- Nga ky nivel takse do të përfitojnë gjithashtu sipërmarrjet në agroturizëm dhe shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor.
- Sot 91% e sipërmarrjeve shqiptare paguajnë zero ose 5% taksë dhe 98% e të punësuarve paguajnë një mesatare prej 5.5% taksë pune nga 10% që paguanin deri dje.
- Ndërkaq TVSH e reduktuar në masën 6% parashikohet për shërbimet brenda strukturave për sipërmarrjet në turizëm dhe agro-turizëm.
- Për t'u ofruar një shtysë të mëtejshme sektorit bujqësor dhe atij energjitik, do të përjashtohen nga TVSH inputet bujqësore si dhe investimet në energji diellore.

Ju uroj një 2019 sa më të suksesshme në sipërmarrjet tuaja dhe ju lutem vijoni ta konsideroni këtë dokument-raport si shteg përmes të cilit të drejtoni çdo shqetësim tuajin ne vijim Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes!
Ju falenderoj për bashkëpunimin e deritanishëm.

Me konsideratë,

Sonila Qato

Regjistri i ankesave të trajtuara

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.1	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	01.11.2018	Subjekti depoziton ankesë ku nëpërmjet së cilës konteston vendimin e raport kontrollin nr 63136/1 datë 10.10.2018.	Trajtuar në process verifikimi me DPT.
Nr.2	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	03.11.2018	Subjekti raporton vonesa në zhdoganim malli.	Trajtuar me DPD.
Nr.3	Bashkia Tiranë	05.11.2018	Subjekti bën kërkesë për likuidim fondesh.	Në proces.
Nr.4	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	06.11.2018	Subjekti raporton ndërprerje të shpeshta të energjisë elektrike.	Trajtuar me përgjigje mbi proceset e njoftimit nga ana e OSHEE.
Nr.5	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	06.11.2018	Subjekti kërkon rikontroll tatimor.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.6	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	07.11.2018	Subjekti kërkon aplikimin e çmimit të referencës në dogana dhe jo të çmimit të transaksionit.	Ne ndjekje me DPD.
Nr.7	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	09.11.2018	Subjekti raporton gjobitje të padrejtë nga ana e Hetimit Tatimor.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.8	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.	10.11.2018	Përcjellje e draft-ligjit për krijimin e urdhërit të inxhinierit dhe urdhërit të arkitektit.	Trajtuar me zgjidhje, në ndjekje.
Nr.9	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	12.11.2018	Subjekti raporton ankesë për veprime e procedura arbitrare nga ana e DRT në kundërshtim të plotë me legjislacionin tatimor.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.10	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	12.11.2018	Subjekti bën kërkesë për informacion në lidhje me grante dhe skema financimi.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.11	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	13.11.2018	Subjekti ngre shqetësim mbi rekomandimet e KLSH ndaj DPD, në lidhje me mos aplikimin e çmimit të transaksionit të deklaruar nga subjekti por aplikimin e çmimit reference.	Në proces.

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.12	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	14.11.2018	Subjekti raporton problematikë në lidhje me kalimin e padrejtë në statusin e biznesit të madh.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.13	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	15.11.2018	Subjekti raporton mungesë informacioni mbi gjobitjen për punonjës të padeklaruar.	Trajtuar me përgjigje sqaruese dhe rekomandim.
Nr.14	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	16.11.2018	Subjekti bën kërkesë për azhornim të statusit të subjektit në sistemin e tatimeve.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.15	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	18.11.2018	Subjekti raporton problematikë në lidhje me rimbursimin e TVSH.	Në ndjekje në bazë të planit të rimbursimeve të prapambetura.
Nr.16	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.	18.11.2018	Subjekti bën ankesë për ndërtimin e një guroreje afër subjektit.	Në ndjekje.
Nr.17	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	19.11.2018	Kërkesë për anulim aktvlerësimi.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.18	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	20.11.2018	Subjekti bën ankesë për mosrespektimin e afateve ligjore për dhënie license.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.19	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.	21.11.2018	Subjekti bën ankesë për fallsifikimin e markës dhe tregëtimit informal.	Në proces ndjekje.
Nr.20	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	22.11.2018	Subjekti bën ankesat mbo referencat doganore.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.21	ZQRPP	22.11.2018	Subjekti ka marrë lejen e përdorimit të objektit në Bashki ndërkohë që nuk është regjistruar në ZRPP.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.22!	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	25.11.2018	Subjekti kërkon vijimin e luftës kundër informalitetit me synim zhdukjen e konkurrencës së padrejtë.	Në proces.

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.23	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	26.11.2018	Subjekti bën kërkesë për ndalimin e tregëtimit online informalisht.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.24	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	26.11.2018	Subjekti raporton mbifaturim nga ana e OSSHEE.	Trajtuar me verifikim dhe përgjigje.
Nr.25	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	27.11.2018	Subjekti dërgon propozim në lidhje me TVSH për shërbime.	Trajtuar me shqyrtim dhe përgjigje.
Nr.26	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	27.11.2018	Subjekti raporton si të padrejtë gjobën e vendosur nga AKU.	Trajtuar me verifikim dhe përgjigje.
Nr.27	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.	28.11.2018	Subjekti raporton problematikë në lidhje me tensionin e lartë dhe si rrjedhojë djegien e makinerive.	Trajtuar me përgjigje,
Nr.28	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	28.11.2018	Subjekti raporton vështirësi në regjistrimin e markës.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.29	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	29.11.2018	Subjekti raporton bllokim të produkteve pa shkak nga Hetimi Tatimor.	Trajtuar me përgjigje sqaruese.
Nr.30	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	29.11.2018	Subjekti ka dërguar sugjerime në lidhje rishikimin e disa pikave në Paketën Fiskale.	Trajtuar me shqyrtim dhe sqarim për secilën pikë.
Nr.31	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	30.11.2018	Subjektet bëjnë kërkesë për sqarim mbi disa çështje të parashikuara nga procedurat e skemave të IPARD.	Trajtuar me sqarim.
Nr.32	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	30.11.2018	Vendosje gjobe për mosprerje të kuponit, anulim akt vlerësimi.	Trajtuar me përgjigje.
Nr. 33	Bashkia Shkodër	30.11.2018	Subjekti denoncon tatim me taksë pasurie në kundërshtim me ligjin për objekt të papërfunduar.	Trajtuar me përgjigje.

